

SEKSIONI I TRETË
ÇËSHTJA LACEJ DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË
(kërkesa nr. 22122/08)

VENDIM

STRASBURG
29 shtator 2022

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen *Lacej dhe të tjerët kundër Shqipërisë*,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë*

dhe Viktoriya Maradudina, *Zëvendësekretare e Përkohshme e Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura, më 8 shtator 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja nisi me një kërkesë kundër Shqipërisë paraqitur në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 5 prill 2008.

2. Kërkuesit u prezantuan nga z. B. Muslija, një avokat i cili e ushtron profesionin në Shkodër.

3. Qeveria shqiptare (Qeveria) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

4. Detajet e kërkuesve dhe detajet që kanë lidhje me kërkesën paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

5. Në thelb, kërkuesit u ankuan për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile, veçanërisht të atyre përpara Gjykatës së Lartë.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS

6. Kërkuesit u ankuan se kohëzgjatja e procedurave civile në fjalë nuk respektonte parashikimin për “afat të arsyeshëm”. Ata u mbështetën në nenin 6§1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Neni 6§1

Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga [një] gjykatë..., në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

A. Kërkuesit Sadik Llukacej dhe Adan Ulqinaku

7. Në lidhje me kërkuesit Sadik Llukacej dhe Adnan Ulqinaku, duke marrë në konsideratë materialet përpara saj, Gjykata thekson se këta kërkues nuk ishin palë në procedurat e brendshme në fjalë. Për këtë arsye, këta kërkues nuk mund të pretendojnë të jenë “viktimë” e shkeljes së të drejtave të tyre të parashikuara në Konventë, për shkak të procedurave që pretendohet të ishin të tejzgjatura. Në vijim rezulton se, sipas gjykimit të Gjykatës, ankesa nuk është në përputhje *ratione personae* me parashikimet e Konventës, sipas nenit 35§3(a), dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35§4 të Konventës.

B. Tri kërkesat e tjera, Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe Komuniteti Musliman i Shqipërisë

8. Për sa u përket kërkuessve: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (*Kisha Ortodokse*); Komuniteti Musliman i Shqipërisë (*Komuniteti Musliman*), Gjykata thekson se ata kanë marrë pjesë në procedurat e brendshme në fjalë, duke përfshirë ato përpara Gjykatës së Lartë. Në lidhje me elementët që ka përpara saj, Gjykata konstaton se ankesa për pikat e ligjit u regjistrua më 26 janar 2010 përpara Gjykatës së Lartë, dhe pas pothuajse katër vjetëve pasiviteti, në vitin 2014, Gjykata e Lartë zhvilloi katër seanca dëgjimore për këtë çështje.

9. Në çështjet kryesore *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014), *Mishgjoni kundër Shqipërisë* (nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010), dhe *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (nr. 43391/18 dhe 17766/19, 12 tetor 2021), Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me problematika të ngjashme me ato në çështjen në fjalë.

10. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e paraqitur përpara saj, Gjykata nuk gjeti ndonjë fakt apo argument, i cili mund të justifikonte kohëzgjatjen e procedurave në nivel kombëtar, veçanërisht përpara Gjykatës së Lartë. Në lidhje me praktikën gjyqësore për këtë lëndë, Gjykata gjykon se në çështjen konkrete, kohëzgjatja e procedurave ishte e tepërt dhe nuk respektohej kërkesa për “afat të arsyeshëm”.

11. Për këtë arsye, ankesa është e pranueshme dhe paraqet një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me tri ankesat e sipërpërmendura.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

12. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”.

13. Duke marrë në konsideratë dokumentet përpara saj dhe praktikën e saj gjyqësore (shih veçanërisht, *Luli dhe të tjerët*, cituar më sipër, dhe *Mishgjoni*, cituar më sipër), Gjykata vendos se është e arsyeshme që të akordohen shumat e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur për tre kërkuessit: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë (*Kisha Ortodokse*), Komuniteti Musliman i Shqipërisë (*Komuniteti Musliman*).

14. Në vijim, Gjykata gjykon se është me vend që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t’i shtohen tre për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *I deklaron* ankesat e paraqitura nga tre kërkuessit: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman, të pranueshme, dhe kërkesat nga dy kërkuessit e tjerë, të papranueshme;

2. *Gjykon* se është shkelur neni 6§1 i Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave civile;

3. *Gjykon*:

a) Se Shteti i Paditur duhet t’u paguajë tre kërkuessve: Hasan Lacej, Kishës Ortodokse dhe Komunitetit Musliman, brenda tre muajve, shumat e paraqitura në tabelën bashkëlidhur, të cilat do të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) Se, që prej përfundimit të periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e sipërpërmendura në një normë të barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së paracaktuar plus tre për qind pikë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 29 shtator 2022, sipas rregullit 77 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Andreas Zünd
KRYETAR

Viktoria Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

SHTOJCË 1
KËRKESA E CILA NGRE ANKESA NË LIDHJE ME NENIN 6§1 TË KONVENTËS
(MOSZBATIM OSE ZBATIM I VONUAR I VENDIMEVE TË BRENDSHME)

Kërkesa nr. ..., data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes, ku është e mundur	Emri i përfaqësuesit dhe vendndodhja	Fillimi i procedurave ose data e hyrjes në fuqi e Konventës për Shqipërinë (2 tetor 1996)	Përfundimi i procedurave	Kohëzgjatja në total Nivelet e juridiksionit	Shuma akorduar për dëmin jopasuror për kërkuar (në euro) ¹	Shuma e akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ²
22122/08, 05/04/2008 (5 kërkes)	Sadik LLUKACAJ 1936 Adnan ULQINAKU 1940	Muslija Bashkim SHKODËR					
	Hasan LACEJ 1935 KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRISË (MYFTINIA SHKODËR)		26/01/2010	24/04/2014	4 vjet dhe 3 muaj, 1 nivel juridiksioni	1,200 Shumë e cila duhet të paguhet për secilin prej tre kërkuarve: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman	250 Shumë e cila duhet të paguhet për të tre kërkuarve së bashku: Hasan Lacej, Kisha Ortodokse dhe Komuniteti Musliman

¹ Plus çdo taksë që mund t'u tarifohej kërkuarve.

² Plus çdo taksë që mund t'u tarifohej kërkuarve.